

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-04/14

Prishtinë, 16 Dhjetor 2015

Në çështjen juridike të:

A.K.

Pala Ankuese

kundër.

M. A.

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Roland Bruin dhe, Ana Bernardek Anëtar, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr.KKPK/D/A/140/2012(lënda është regjistruar në AKP me numrin 14805), i datës 29 shkurt 2012, pas shqyrtimit të mbajtur 16 Dhjetor 2015, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. **Ankesa e A. K. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCK/D/A/140/2012 refuzohet si e pabazuar;**
2. **Konfirmohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/140/2012, date 29 Shkurt 2012 për sa i përket kërkesës nr.KPA14805.**

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Me 04 dhjetor 2006, M. A.(ne tekstin e mëtejme: Pala Përgjegjëse ne Ankesë) ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar ri posedimin të ngastrave nr.302, 303 dhe 304 me sipërfaqe totale prej 0.28.62 ha, që gjenden në zonën kadastrale Nekodin, komuna e Ferizajt. Ai ka shpjeguar se prona kërkuar ishte pronë e tij, dhe se njëta është uzurpuar nga persona të panjohur. Ajo pronë ishte humbur si rezultat i rrethanave ne vitet 1998/1999 dhe tregoi se data e humbjes ishte 13 qershor i vitit 1999.
2. Për ta mbështetur kërkesën e tij, Pala Përgjegjëse ne Ankesë ka paraqitur në AKP:
 - Kopje te Aktvendimit te trashëgimisë te Gjykatës Komunale në Ferizaj T.nr.77/96 i dt.08 korrik 1997. Nëpërmjet këtij aktvendimi Pala Ankuese ishte deklaruar si trashëgimtar i ngastrave kadastrale pas vdekjes së nënës se tij S. A.
3. Kërkesa ishte njoftuar fillimisht ne 11 Tetor 2007. Një njoftimi i dyte i kërkesës ishte bere ne 31 Gusht 2010 nëpërmjet publikimit ne Gazetën e Njoftimeve te KPA nr.8 dhe Buletinin e Njoftimeve Pronësore te UNHCR-se. Gazeta ishte shpërndarë ne disa zyra komunale dhe një kopje e saj ishte lënë ne një dyqan. Asnjë pale përgjegjëse nuk është paraqitur për te shprehur interes ligjor mbi pronat e kërkuara.
4. Sipas Raportit te konsoliduar te verifikimit, dokumentet e dorëzuara nga pala përgjegjëse ne ankesë si prova ishin verifikuar pozitivisht.
5. Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) me vendimin e tij KKPK/D/A/140/2012, i datës 29 shkurt 2012, i ka pranuar Palën Përgjegjëse ne Ankesë si pronar te pronës se kërkuar
6. Vendimi i është dorëzuar Palës Përgjegjëse ne Ankesë ne 24 Maj 2012
7. Ne 16 Shtator 2013, A. K.(ne tekstin e mëtejme: Pala Ankuese) ka paraqitur ankesë kundër vendimit të Komisionit KKPK/D/A/140/2011, i datës 29 shkurt 2012.

8. Në ankesën e tij ai thekson se vendimi ankimor është marr me vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, gjithashtu me aplikim të gabuar të ligjit material. Ai kërkoi ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe të vërtetohet se ai i ka blerë pronat e kërkuara.
9. Ankesës ai i ka bashkangjitur deklaratën e H. dhe S. Q. të dt. 16 shtator 2013 të dhënë para noterit publik G. H.. Këta dëshmitar deklarojnë se Pala Ankuese në vitin 1985 i ka blerë pronat e paluajtshme nga S.A. kundrejt shumës prej 6.000DM dhe kontrata e shkruar është djegur gjatë luftës në Kosovë. Po kështu, Pala Ankuese ka paraqitur edhe padinë në Mars 2013 në emër të paditësit A. F. i cili pretendon se prona e kërkuara janë blerë nga ky paditës.
10. Ankesa i është dorëzuar Palës Përgjegjëse në Ankese në 13 Janar 2014. Pala Përgjegjëse në Ankese nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Arsyetim ligjor:

Pranueshmëria e ankesës

11. Ankesa është e pranueshme. Pala ankuese nuk është njoftuar mbi procedurat përpara KKKP-se siç është parashikuar në Seksionin 10.1 të Rregullores së UNMIK 2006/50 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale të ndryshuar me Ligjin Nr.03 / L-079 (në tekstin e mëtejshëm Ligji Nr. 03 / L-079). Njoftimi i kërkesës ishte bërë nëpërmjet publikimit në Gazetën e Njoftimeve të AKP-se nr.8 dhe Buletinit të Njoftimeve të Zyrës së UNHCR-se. Gjykata Supreme në juridiksionin e saj i ka konsideruar njoftime të tilla si të pamjaftueshme, sepse kjo nuk përbën "përpjekje të arsyeshme" për të njoftuar çdo person tjetër i cili mund të ketë një interes ligjor në pronën (argumentuar sipas Seksionit 10.1 të Ligjit nr.03/L-079). Për këtë arsye njoftimi i bërë në rastin konkret duhet të konsiderohet si jo korrekt dhe si i tillë nuk mund të ketë ndikim negativ mbi të drejtat e Palës Ankuese.
12. Prandaj, Gjykata Supreme është e mendimit se Pala Ankuese duhet të pranohet si pale në procedurat që po zhvillohen në këtë fazë (sipas Seksionit 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50) dhe ankesa e tij duhet të konsiderohet e pranueshme.

Meritat e ankesës

13. Gjykata konstaton se Pala Ankuese nuk ka mundur te provoje ndonjë te drejte mbi pronën e kërkuar me ane te dokumenteve te dorëzuara. Ai nuk arriti të provojë në asnjë mënyrë ndonjë të drejtë pronësore mbi pronën e kërkuar apo për kundërshtojë me sukses konstatimin e KKPK-së te dhënë ne vendimin KKPK/D/A/140/2012, date 29 Shkurt 2012 se Pala përgjegjëse ne Ankese është pronare e 1/1 pjese te pronës se kërkuar. Është e rëndësishme te nënvizohet se barra e provës lidhur me rrethanat e fitimit te se drejtës se pronësisë mbi pronën e kërkuar i takon Palës Ankuese. Ne përputhje me nenin 7 te Ligjit nr.03/L-006 Mbi Procedurën Kontestimore “palët duhet ti paraqesin te gjitha faktet mbi te cilat ato bazojnë kërkesat e tyre dhe te propozojnë prova te cilat vërtetojnë këto fakte”. Meqenëse Pala Ankuese ka arritur ne përfundimin se ka fituar te drejtën e pronësisë mbi pronën e kërkuar ne baze te kontratës te lidhur ne 1985, ai duhet te provoje këtë rrethane gjate procedurës. Megjithatë provat e dorëzuara prej tij bashke me ankesën nuk mund te vlerësohet se provojnë këtë rrethane.
14. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme gjen se KKPK-ja e ka bazuar vendimin ne përcaktimin korrekt dhe te plote te gjendjes faktike dhe ne aplikimin e duhur te ligjit material. Prandaj, Gjykata Supreme arrin ne përfundimin se ankesa është e pabazuar.
15. Bazuar ne sa me sipër dhe ne pajtim me nenin 13.3 nen-paragrafi (c) te Ligjit 03/L-079, është vendosur si ne dispozitiv te këtij vendimi.
16. Prandaj, ankesa duhet të refuzohet si e pabazuar (neni 13.3 (c) i Ligjit nr. 03/L-079 dhe me nenin. 195. Par.1 nen paragrafi (d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore).

Këshillë juridike

17. Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me ankesë apo mjete të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar e Kolegjit, EULEX

Anna Bednarek, Gjyqtar i EULEX-it

Rolandus Bruin, Gjyqtar e EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it